



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1356/ 6 prot.

Datë 08.05.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 611/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-76239-02-16-2026, me objekt: “Riveshje me asfalt per vitin 2026 Loti :1”, me fond limit 136,184,215.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “NG STRUCTURES” SHPK dhe “G.P.G. COMPANY” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar

**Ankimues:**

BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK me NIPT K32618815N dhe L04803001U si dhe adresë: Kryeluzaj, Kavaje

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Vlorë me adresë: Sheshi 4 heronjtë, Vlorë

**Subjekt i interesuar:**

BOE “NG STRUCTURES” SHPK dhe “G.P.G. COMPANY” SHPK me NIPT L79326502O dhe J64324443V si dhe adresë: *Operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK me NIPT L79326502O dhe*

adresë: Tirane, Rruga Kosovareve, Rruga Ndreko Rino,  
Pallatet Viridario, Hyrja 1, Kati 3, Ap 35

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. BOE ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.02.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-76239-02-16-2026, me objekt: “Riveshje me asfalt per vitin 2026 Loti :1”, me fond limit 136,184,215.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 07.04.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 17.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

-BOE “BIBA-X” & “R S M CONSTRUCTION	94,147.956 lekë	skualifikuar
- BOE “NG structures” SHPK dhe “G.P.G. Company” SHPK	102,431,589 75 lekë	kualifikuar
-BOE “Euroteorema Peqin”& “Beqiri” SHPK & “Pepa Group” SHPK	108.799.084. 43 lekë	kualifikuar
- “Avduli” SHPK	109.495.397 lekë	kualifikuar
- “Vellezerit Hysa “ SHPK	115.235.694 lekë	kualifikuar
-“2 T”	120.354.391.50 lekë	kualifikuar
- BOE "Shkelqimi 07" & “Z d r a v a” SHPK	128.915.062.50 lekë	kualifikuar
- “Fled” SHPK	131,646,240.6 lekë	skualifikuar

II.3.1. Referuar sistemit të prokurimit elektronik BOE “BIBA-X” & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet si vijon: *“Oferte anomalisht e ulet. Ne baze te VKM Nr.285 date 19.05.2021, Neni 82, pika 4, paragrafi 3 "Ne procedurat e prokurimit me vlere nen kufirin e larte monetar, nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kerkuar sqarim ofertuesit.”*

II.4. Në datën 29.04.2026 është publikuar në SPE, Njoftimit i Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Me datë 01.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6608, dhe me Nr.1356/2026 Prot., datë 04.05.2026 e BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK për procedurën e prokurimit, “E hapur” me Nr. REF-76239-02-16-2026, me objekt: “Riveshje me asfalt per vitin 2026 Loti :1”, me fond limit 136,184,215.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me

kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK, si edhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “NG structures” SHPK dhe “G.P.G. Company” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.1356/1 prot., datë 04.05.2026.

II.7. Me datë 04.05.2026 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin e Komisionit të Shyrimit të Ankesave (KSHA) me nr. 8578/3 prot., datë 04.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1356/2 prot., datë 05.05.2026 nga ku rezulton se KSHA nuk e ka pranuar ankesën duke argumentuar: “[...]”

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ngrihen pretendime nga Operatori ekonomik **BIBA-X** mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

***Sipas Operatorit ai argumenton se ka fakte dhe prova sipas të cilave kemi të bëjme me një shkellje haptazi të barazisë në tendera publike, përdirimin dhe shpërdorim të fondeve publike.Referuar ndryshimeve të bera në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, per procedura te cilat parashikojne se ne procedurat me vlera nën kufirin e lartë monetar autoriteti mund të refuzojë ofertën që vlerësohet anomalisht e ulët pa kërkuar***

*të parë shpjegime, ky përjashtim nuk përjashton detyrimin për të arsyetuar vendimin dhe për të pasur baza objektive të verifikueshme, për vlerësim e ofertës si të tillë. Sipas op. oferta prej 82,116,573 lekë pa tvsh është vetëm 8.77% më e ulët se oferta e operatorit tjetër dhe nuk e justifikojnë në asnjë mënyrë klasifikimin si “anomalisht e ulët”, pasi janë brenda kufijve normalë të konkurrencës dhe nuk tregojnë pamundësi ekonomike apo teknike për përmbushjen e kontratës.*

Ne si KSHA pasi u njohëm me ankesën e depozituar nga Operatori Ekonomik dhe pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderit për këtë procedurë po ju paraqesim konstatimet lidhur me pretendimet e paraqitura nga Operatori Ekonomik si më poshtë vijon:

Vendimi për skualifikimin e operatorit ekonomik nga KVO për arsyen e sipërcituar në ankesë qëndron, konkretisht:

**Së pari** –Skualifikimi i operatorit Ekonomik BIBA-X, si ofertë anomalisht e ulët është kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht:

***Oferta anomalisht e ulët në mbështetje të Nenit 93 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X Nenit 82 pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM Nr.498 dt.01.08.2024,i ndryshuar me VKM nr.545 dt.04.09.2024. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar ,nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta ,komisioni i vleresimit te ofertave i refuzon ato duke i s’kualifikuar nga procedura pa i kerkuar sqarim ofertuesit/sve .***

**Së dyti**- në lidhje me verifikimin për kapacitetet teknike, të burimeve njerëzore dhe të mjeteve në dispozicion të operatorit të shpalluar fitues po ju sqarojmë si më poshtë:

OE i shpallur fitues në baze të verifikimit të dokumentave të depozituara prej tij rezulton se i plotëson kriteret për përballimin e realizimit me sukses të të dyja kontratave pasi Disponon:

- Kapacitete teknike: Inxhinera + staf mbështetës
- Burimet njerëzore prej 363 punonjës
- Mjetet sipas kërkesës së AK

Në përmbyllje, Komisioni konstaton se:

1. **Pretendimi i operatorit ekonomik për të dyja pikat nuk qëndron.**

**konkluzion:**

**Sa më sipër, referuar të dyja pikave të ankesës Komisioni i Shqyrtimit  
VENDOSI:**

- Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BIBA-X.**

II.8. Informacionin për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 1356/3 prot., datë 07.05.2026.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK për skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“Oferte anomalisht e ulet. Ne baze të VKM Nr.285 date 19.05.2021, Neni 82, pika 4, paragrafi 3 "Ne procedurat e prokurimit me vlere nen kufirin e larte monetar, nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kerkuar sqarim ofertuesit.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 1 dhe 7 të nenit 34 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

*1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysht kur përlllogarit vlerën e prokurimit.*

*7. Kur një punë, mall ose një shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysht vlere e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.”*

III.1.2. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:*

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.3. Në nenin 12 “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “8. Kur një punë, mall ose shërbim mund të rezultojë në dhënie të disa kontratave në formën e loteve të veçanta, për qëllim të përllogaritjes së vlerës së kontratës, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritjes;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Në Kreun II “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë2 ; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.  
2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK, si edhe nga përllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta e tyre ekonomike në vlerën prej 94,147.956 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 4 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët.

Për të gjykuar mbi veprimet e mëtejshme të autoritetit kontraktor i cili pas konstatimit të ofertës anomalisht të ulët të BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK e ka refuzuar atë menjëherë pa kërkuar sqarime, KPP do të shprehet së pari mbi llojin e procedurës pra nëse jemi para procedurës së hapur apo të hapur mbi kufirin e lartë monetar. Nga hetimi administrativ KPP konstaton se procedura e prokurimit objekt ankimi (loti përkatës) e tipit të kontratës “Punë” e ka fondin limit 136,184,215.00 lekë pa TVSH, por referuar pikës 8 të nenit 12 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke qenë se jemi para kushtit të dhënies së kontratave në formën e loteve të veçanta ne përllogaritjen e vlerës së kontratës, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve pra vlera e tenderit kryesor që në këtë rast është 255,875,077.00 lekë pa TVSH, vlerë e cila sipas aktit rregullator për përcaktimin e kufijve monetarë në sektorin klasik e klasifikon procedurën në llojin “E hapur” por nën kufirin e lartë monetar. Duke i qëndruar strikt këtij rregullimi referuar dosjes së tenderit në seksionin “të dhënat kryesore” autoriteti kontraktor ka përcaktuar tipin e kontratës “punë” dhe llojin e

procedurës “E hapur” dhe mbi këtë parashikim verifikohet nga organet e vlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të ankesave plotësimi i kushteve formale lidhur me afatet e ankimit në kuptim të nenit 110 të LPP-së si dhe çdo rregullim tjetër ligjor gjatë shqyrtimit në themel të çeshtjes ku përfshihen edhe hapat proceduriale që duhet të ndiqen nga autoritetet kontraktore në rastin e konstatimit të ofertave anomalisht të ulëta. Referuar kreut II të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, në të cilin përcaktohet se: “1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë ; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë. 2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.” vlera e tenderit kryesor 255,875,077.00 lekë pa TVSH për tipin e kontratës “Punë” sipas kuadrit rregullator e klasifikon procedurën “nën kufirin e lartë monetar”. Për sa më sipër asyetuar, KPP në rastin konkret gjykon se vendimi i KVO së autoritetit kontraktor për skualifikimin pa kërkuar sqarime të ofertës së BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK e cila në aplikim të formulës rezulton anomalisht e ulët është një vendim në përputhje me parashikimet e pikës 5, të nenit 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe si i tillë është një akt administrativ i vlefshëm pasi procedura e prokurimit (vlera e tenderit kryesor) është nën kufirin e lartë monetar, dhe autoritetet ose entet kontraktore kur ndodhen përballë një fakti të tillë refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK mbi kualifikimin e BOE “NG Structures” SHPK dhe “G.P.G. Company” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.2.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. *Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*”.

III.2.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

*1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.2.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në këtë rast BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK vijon të mbetet i skualifikuar sipas arsytimit më sipër të KPP dhe në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e BOE ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

*miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-76239-02-16-2026, me objekt: “Riveshje me asfalt per vitin 2026 Loti :1”, me fond limit 136,184,215.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “BIBA-X” SHPK & “R|S|M CONSTRUCTION” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

